

BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E ARSIMIT
 DHE SPORTIT
 AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE

PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2015

I DETYRUAR

VARIANTI **A**
 Ora 10.00

E premte, 29 maj 2015

Lënda: Gjuhë shqipe dhe Letërsi

Profesionale, artistike, sportive, me kohë të shkurtuar

Udhëzime për nxënësin

Testi në total ka **25 pyetje**: 13 pyetje me zgjedhje (alternativa) dhe 12 pyetje me zhvillim.

Testi është i ndarë në dy pjesë: joletrare dhe letrare.

Në të dy pjesët ka pyetje me **zgjedhje** dhe me **zhvillim**. Në pyetjet me zgjedhje rrethoni **vetëm** shkronjën përbri përgjigjes së saktë, ndërsa për pyetjet me zhvillim është dhënë hapësira e nevojshme për të shkruar përgjigjen.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është **2 orë e 30 minuta**.

Pikët për secilën kërkesë janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Pikët										
Kërkesa	11	12a	12b	13	14	15	16	17	18	19
Pikët										
Kërkesa	20	21	22	23	24	25a	25b	25c	25d	
Pikët										

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

Reklamat

Specialistët tregojnë se një ekonomi e shëndetshme varet nga një qarkullim i shëndetshëm i mallrave dhe i shërbimeve. Kur njerëzit ndalojnë së bleri dhe së shituri, ekonomia fillon të bjerë. Njerëzit varfërohen dhe jeta kthehet në një luftë për mbijetesë.

Kushdo që dëshiron të shesë diçka, duhet t'u bëjë të ditur njerëzve se çfarë është ajo që kërkon të shesë dhe sa kushton. Një shitës duhet të tregojë mallra dhe t'i bindë njerëzit se ata kanë nevojë për to. Me fjalë të tjera, një shitës duhet të reklamojë.

Kohët e fundit është bërë e modës që reklamat të kritikohen me idenë se ato zhvatin konsumatorin dhe ndotin zona të tëra me grumbuj hedhurinash.

Një pjesë e reklamave shumëngjyreshe në revista të shkëlqyera, si dhe disa programe zbatimëse në televizion përçmohen jo vetëm se fyejnë inteligjencën e të rriturve, por edhe se dëmtojnë mendjet e fëmijëve dhe të të rinjve (dhe kjo është më e keqja).

Megjithatë, televizionet dhe revistat do të falimentonin pa reklamat, pasi ato kontribuojnë në një pjesë të madhe të të ardhurave të tyre.

Një tjetër përgjegjësi që i ngarkohet industrisë së reklamave, është se reklamimi i nxit njerëzit të blejnë gjëra që realisht nuk u duhen. Një pohim ky, paksa, i pazakontë për një demokraci liberale që mbështetet në parimet e zgjedhjes së lirë.

Kjo përgjegjësi krijon vizionin e një qytetari të pafuqishëm, që ndodhet në mes të një mekanizmi të "shpëlarjes" së trurit. Kërkoni po të doni, por kurrë nuk do të gjeni në regjistrat e gjyqeve një rast të vetëm të një qytetari të pafajshëm, që është detyruar nga reklamuesit apo reklamat, të blejë diçka që ai ose ajo nuk e ka dashur.

Le t'i lëmë blerësit t'i hapin vetë sytë, por mos iu shmangni periudhës kur çmimet bien ndjeshëm vetëm se disa njerëz kanë mendime negative.

Disa kritikë mendojnë se reklamat kontribuojnë në shtimin e ndotjes dhe po përshpejtojnë zhdukjen e materialeve të rralla nga planeti. Deri diku, kjo mund të jetë e vërtetë, por në këtë çështje ndikojnë edhe faktorë të tjerë, si: konsumatorët që i dëshirojnë këto mallra, prodhuesit që përfitojnë nga produktet e tyre, qeveria që ka nevojë për taksat që vijnë nga ekonomia e kështu me radhë. Shqyrtojeni me kujdes këtë listë dhe shikoni se ku ndodheni ju vetë.

Herën tjetër, kur të dëgjoni dikë të thotë se *reklama ka një ndikim të pafavorshëm në ekonomi*, risillni në mendje se ajo është katalizator në procesin e shitjes dhe të blerjes.

1. Si është organizuar ky shkrim?

1 pikë

- A) Ideja kryesore mbështetet nga të dhëna statistikore.
- B) Idetë kritike kundërshtohen nga pohime logjike.
- C) Një numër çështjesh prezantohen për zhvillime të mëtejshme.
- D) Një numër çështjesh merren në konsideratë nga rëndësia historike.

2. Cila është teknika që përdor autori për të përforcuar argumentet e tij në lidhje me reklamat?

1 pikë

- A) Duke përdorur dëshmi personale.
- B) Duke dhënë statistika për të treguar efektshmërinë.
- C) Duke iu referuar edhe aspekteve pozitive, edhe atyre negative.
- D) Duke përshkruar reklamat që kanë qenë të suksesshme.

3. Cili nga pohimet e mëposhtme është shembull i një logjike të gabuar? 1 pikë
- A) Shitësit duhet të bëjnë reklama, me qëllim që njerëzit të dinë se çfarë është në shitje.
 B) Nëse nuk do të ketë reklama zbavitëse në televizion, stacionet televizive do të falimentonin.
 C) Ju nuk mund ta çoni një kompani në gjyq, sepse ajo i ka shitur një blerësi diçka që atij nuk i nevojitet.
 D) Prodhuesit shpesh kontribuojnë në ndotjen e planetit dhe përshpejtojnë shterimin e burimeve natyrore.
4. Alternativa që tregon më qartë pikëpamjen e autorit është: 1 pikë
- A) Reklammat ndikojnë në ndotjen e ambientit.
 B) Reklammat fyejnë inteligjencën e të rriturve.
 C) Reklammat janë pjesë e rëndësishme e një ekonomie të shëndetshme.
 D) Reklammat i nxisin njerëzit të blejnë gjëra, që nuk i dëshirojnë ose nuk kanë nevojë.
5. Cila nga fjalitë e dhëna është **OPINION**? 1 pikë
- A) Disa revista përmbajnë reklama shumëgjyreshe.
 B) Reklamimi ndikon në qarkullimin e mallrave dhe të shërbimeve.
 C) Të ardhurat e stacioneve televizive komerciale varen nga reklammat.
 D) Reklamimi i detyron konsumatorët të blejnë artikuj që nuk u nevojiten.
6. Bazuar në artikull, çfarë do të ndodhte nëse nuk do të kishte reklama? 1 pikë
- A) Qytetarët do të bëheshin konsumatorë më të zgjuar.
 B) Bujqësia do të dominonte në vendimet ekonomike.
 C) Ndotja dhe shterimi i burimeve natyrore do të rritej.
 D) Shkëmbimi i mallrave dhe i shërbimeve do të ulej ndjeshëm.
7. Ç'loj argumentesh mbizotërojnë në këtë tekst? 1 pikë
- A) Argumente logjike.
 B) Argumente shkencore.
 C) Argumente të autoriteteve të fushës përkatëse.
 D) Argumente të mbështetura në të dhëna statistikore.
8. Zbuloni dy karakteristika tipike të strukturës së këtij teksti. 2 pikë
- _____
- _____

9. Gjeni tezën që shtron autori dhe dy argumente në mbështetje të saj. **3 pikë**

Teza: _____

Argumenti 1: _____

Argumenti 2:

10. Cila është kundërteza (antiteza)? Zbuloni dy nga pasojat negative që sjell reklamimi i mallrave. **3 pikë**

Kundërteza: _____

Pasoja 1: _____

Pasoja 2: _____

11. Cilat janë dy prej teknikave që përdor autori për të përfshirë lexuesin në problemin që trajton? **2 pikë**

12. a) Si e kuptoni shprehjen “mekanizëm i shpëlarjes së trurit”? Ç’qëndrim mban autori në lidhje me këtë fenomen? **2 pikë**

- b) Tregoni dy burime që do të përdornit nëse do të shkruani një artikull kërkimor dhe të përshtatshëm, në lidhje me ndikimet që kanë reklamat tek konsumatori. **2 pikë**

Viktor Hygo

Katedralja e Parisit

Tani, në vitin 1482, Kuazimodoja ishte djalë i rritur. Që prej disa vjetësh, ai ishte bërë kambanar i katedrales së Shën Mërisë në sajë të babait të tij për shpirt, Klod Froloit.

I veçuar përgjithnjë nga bota për shkak të fatkeqësisë së tij të dyfishtë: prejardhjes së panjohur dhe shëmtimit fizik, i mbyllur që në fëmëni brenda këtij rrethi të dyfishtë e të pakapërcyeshëm, i shkreti Kuazimodo u mësua të mos shihte asgjë tjetër në këtë botë, përveç mureve të shenjta që e kishin strehuar në hijen e tyre. Dora-dorës që ai u rrit dhe u zhvillua, katedralja e Shën Mërisë u bë për të veza, foleja, shtëpia, atdheu dhe, së fundi, vetë rruzullimi.

Kështu, dalëngadalë, duke u zhvilluar gjithnjë në hijen e katedrales, duke jetuar e duke mos dalë pothuajse kurrë së andejmi dhe duke ndier orë e çast mbi vete ndikimin e mistershëm të asaj godine, ai arriti, më në fund, t'i ngjasonte asaj, të trupëzohej me të, të shndërrohej, si të thuash, në një pjesë të saj përbërëse. Këndet e dala të trupit të tij dukej sikur ishin krijuar kastile për të hyrë (le të na lejohet shprehja!) në këndet e futura të ndërtesës, dhe Kuazimodoja dukej jo vetëm banor i katedrales, por edhe përmbytja e saj e natyrshme. Mund të thuhet gati pa e tepruar se ai kishte marrë formën e katedrales, ashtu siç merr kërmilli formën e guaskës së vet.

Kuazimodoja kishte lindur gungaç, çalaman dhe gjysmë i verbër. Vetëm me mundim dhe me durim të madh kishte mundur Klod Froloi ta mësonte të fliste. Por fati i keq nuk i ndahej atij fëmije të gjetur, të mjerë. Pasi u bë kambanar i katedrales, në moshën katërmëdhjetë vjeç, i ra në kokë edhe një fatkeqësi tjetër: nga zhurma e kambanave iu çapa daullja e veshit dhe ai u shurdhua. E vetmja derë, që natyra ia kishte lënë të hapur për të mos u veçuar krejtësisht nga bota, u mbyll papritmas për jetë të jetës.

Duke u mbyllur, kjo derë ndali të vetmen rreze gëzimi dhe drite që depërtonte ende në shpirtin e Kuazimodos. Atëherë ky shpirt u krodh në errësirë të thellë.

Trishtimi i fatiut u bë tani i pashërueshëm dhe i plotë, siç ishte dhe shëmtimi i tij. Le të shtojmë se shurdhësia e bëri thujtë edhe memec. Sepse, për të mos iu dhënë të tjerëve shkak të qeshnës, Kuazimodoja, sapo e pa që ishte shurdhuar, e dënoi veten me një heshtje, të cilën e thyente vetëm atëherë kur s'kishte njeri pranë. Ai e lidhi me dashje atë gjuhë që Klod Froloi mezi ia pat zgjidhur. Për këtë arsye, kur e detyronte nevoja të fliste, gjuha e tij kthehej e vërtetë me ngathtësi, si një derë që i ka menteshat të ndryshkura.

Nuk ka dyshim se, kur trupi është gjymtuar, gjymtohet edhe mendja. Kuazimodoja mezi ndiente që brenda vetes së vet rektinte një shpirt i krijuar sipas shëmbëlltyrës së trupit. Mbresat e jashtme pësonin një përthyerje të çuditshme para se të arrinin në vetëdijen e tij, truri i Kuazimodos ishte një ambient i veçantë; gjithçka që hynte në të, dilte së andejmi e shtrembëruar. I detë e tij, që ishin pasqyrim i këtyre mbresave të përthyerë, paraqiteshin sigurisht të shtrembëruara dhe të pështjelluara.

Pasoja e parë e një formimi të tillë mendor ishte se Kuazimodoja nuk mund t'i shihte sendet ashtu siç ishin. Prej tyre nuk fitonte dot asnjë mbresë të drejtpërdrejtë. Prandaj bota e jashtme i dukej shumë më e largët se sa neve.

Pasoja e dytë e kësaj fatkeqësie ishte ligësia e tij.

Dhe, me të vërtetë, ai ishte i lig, sepse rronte i vetmuar si njerëzit e pyjeve, dhe rronte i vetmuar, sepse ishte i shëmtuar. Natyra e tij kishte në vetvete një farë logjike, siç ka dhe natyra jonë.

Forca e tij fizike, e zhvilluar jashtë masës, ishte edhe ajo një shkak ligësie.

Sidoqoftë, ne duhet të tregohemi të drejtë dhe të themi se, ndoshta, ligësia e tij nuk ishte diçka e lindur së bashku me të. Qysh në hapat e parë që pat bërë ndërmjet njerëzve, ai e kishte ndier dhe pastaj e kishte parë veten të përbuzur, të përqeshur, të poshtëruar. Të folurit e njerëzve ishte për të ose një përqeshje, ose një mallkim. Duke u rritur ai kishte gjetur përqark tij vetëm urrejtje. Këtë urrejtje ai e kishte përvetësuar, ishte bërë i lig si të tjerët dhe kishte rrokur armën me të cilën e patën plagosur.

13. Epitetet e shumta që gjenden në fragment zbulojnë: **1 pikë**
- A) sjelljen e Klod Froloit kundrejt Kuazimodos.
 - B) gjendjen fizike dhe emocionale të Kuazimodos.
 - C) marrëdhënien e Kuazimodos me natyrën.
 - D) reagimin e njerëzve kundrejt tij.
14. Në cilën prej alternativave të mëposhtme është përdorur gjuha e figurshme? **1 pikë**
- A) Kuazimodoja kishte lindur gungaç, çalaman dhe gjysmë i verbër.
 - B) Ai ishte bërë kambanar i katedrales së Shën Mërisë në sajë të babait të tij për shpirt, Klod Froloit.
 - C) Kur e detyronte nevoja të fliste, gjuha e tij kthehej e vërtitej me ngathtësi, si një derë që i ka menteshat të ndryshkura.
 - D) Pasoja e parë e një formimi të tillë mendor ishte se Kuazimodoja nuk mund t'i shihte sendet ashtu siç ishin.
15. Nisur nga konteksti, kur autori thotë: *“E vetmja derë, që natyra ia kishte lënë të hapur për të mos u veçuar krejtësisht nga bota, u mbyll papritmas për jetë të jetës”*, ai nënkupton: **1 pikë**
- A) humbjen e aftësisë për të dëgjuar.
 - B) humbjen e besimit tek njerëzit.
 - C) humbjen e dëshirës për të folur.
 - D) humbjen e interesit për botën që e rrethonte.
16. Në cilën prej alternativave të mëposhtme është përdorur antonimia? **1 pikë**
- A) Idetë paraqiteshin sigurisht të shtrembëruara dhe të pështjelluara.
 - B) Ai e lidhi me dashje atë gjuhë që Klod Froloi mezi ia pat zgjidhur.
 - C) Të folurit e njerëzve ishte për të ose një përqeshje, ose një mallkim.
 - D) Por fati i keq nuk i ndahej atij fëmije të gjetur, të mjerë.
17. E vetmja gjë që i jep qetësi Kuazimodos është: **1 pikë**
- A) ushtrimi i forcës.
 - B) mësimi i të folurit me Klod Froloin.
 - C) jetesa brenda katedrales.
 - D) soditja e natyrës rreth katedrales.
18. Karakteristikë e stilit të Hygoit në këtë fragment është: **1 pikë**
- A) thjeshtësia e rrëfimit.
 - B) gjuha e pasur figurative.
 - C) abstragimi filozofik.
 - D) fragmentarizmi i theksuar.

19. Çfarë raporti ka Kuazimodoja me katedralen? Pse?

2 pikë

20. Gjeni dy arsytet që kanë sjellë fillimisht veçimin e Kuazimodos nga njerëzit e tjerë.

2 pikë

21. Cila është ndjesia që provon Kuazimodoja, kur e kupton se nuk dëgjon më? Pse?

2 pikë

22. Cili është qëndrimi që shoqëria mban kundrejt Kuazimodos? Çfarë ju bën përshtypje në këtë qëndrim? Argumentoni mendimin tuaj.

3 pikë

23. Zbërtheni nëntekstin e fjalive të mëposhtme, duke u bazuar në figuracionin që ato mbartin.

3 pikë

Duke u mbyllur, kjo derë ndali të vetmen rreze gëzimi dhe drite që depërtonte ende në shpirtin e Kuazimodos. Atëherë ky shpirt u krodh në errësirë të thellë.

24. Zbuloni qëndrimin që mban autori ndaj figurës së Kuazimodos. Nisur nga momentet në të cilat ai shfaqet, analizojeni atë duke përdorur ilustrime nga fragmenti.

3 pikë
